



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.6/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kujtim Pasul- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, të paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2216/2025, të datës 21.08.2025, për shkak të mos çertifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 29.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2216/2025, i datës 21.08.2025, për shkak të mos çertifikimit të Listës së kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunës të subjektit politik Demokracia Serbe, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

II. ANULOHET Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2216/2025, i datës 21.08.2025, URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të çertifikojë listën e kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunës të subjektit politik Demokracia Serbe, sipas Rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ-së, i datës 21.08.2025, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 28.08.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, e dorëzuar përmes postës së Kosovës me datën 22.08.2025, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për refuzimin e certifikimit të listës së kandidatëve të subjektit politik Demokracia Serbe për zgjedhjet lokale.

Parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në nenin 115 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, të ndryshuar, subjekti politik Demokracia Serbe ngre ankesë kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ) i cili hodhi poshtë rekomandimin

e Zyrës (ZRCFKSP) për Konfirmimin e Listave të Kandidatëve, megjithëse i njëjti rekomandim thotë se nuk ka pengesa ligjore për verifikimin e listës dhe kandidatëve.

Më tutje në ankesë theksohet se KQZ më 21.8.2025 mori vendim për të hedhur poshtë rekomandimin e ZRCFKSP për konfirmimin e listës së kandidatëve dhe kandidatëve për kryetarë të komunave të subjektit politik Demokracia Serbe në katër komuna. Në shpjegim, thuhet se nuk u konstatua asnjë pengesë ligjore për verifikimin e listës, por megjithatë vendimi u mor në kundërshtim me rekomandimin dhe pa një bazë të vlefshme ligjore. Kjo shkeli drejtpërdrejt të drejtat kushtetuese dhe ligjore të subjekteve politike dhe kandidatëve.

Parashtruesi i ankesës thekson se neni 27 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (03/L-073) - përcakton që KQZ-ja verifikon listat e kandidatëve nëse nuk ka pengesa ligjore, ndërsa neni 30 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (03/L-073) - përshkruan në detaje kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët dhe listat e kandidatëve. Meqenëse ZRCFKSP përcaktoi se të gjitha kushtet formale ishin përmbushur dhe se nuk kishte pengesa, KQZ-ja ishte e detyruar të kryente një verifikim. Ndërsa neni 115 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme - parashikon të drejtën e një subjekti politik për të apeluar vendimet e KQZ-së para PZAP-së, nëse konsiderohet se vendimet janë marrë në kundërshtim me ligjin.

Me tej parashtruesi i ankesës thekson se neni 45 i Kushtetutës së Kosovës - garanton të drejtat aktive dhe pasive të votimit, pra të drejtën e qytetarëve për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim. Neni 31 i Kushtetutës së Kosovës - e drejta për vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme. Neni 54 i Kushtetutës së Kosovës - garanton të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe institucionale kur shkelen të drejtat kushtetuese dhe ligjore. Neni 15 i Ligjit nr. 05/L-021 për ndalimin e diskriminimit - ndalon çdo pengim të pabazuar të aktivitetit politik dhe pjesëmarrjes në zgjedhje. Neni 3 i Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - e obligon Kosovën të sigurojë zgjedhje të lira dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje politike.

Parashtruesi i ankesës thekson se vendimi i KQZ-së u miratua pa bazë ligjore, është në kundërshtim me gjetjet e shërbimit të vet të ekspertëve (ZRCFKSP), shkel të drejtat themelore zgjedhore dhe kushtetuese të subjekteve politike dhe kandidatëve, përfaqëson një formë të zbatimit selektiv dhe diskriminues të të drejtave.

I njëjt kërkon nga PZAP-i që në bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të miratojë ankesën e subjektit politik Demokracia Serbe si e bazuar, të anulojë vendimin e KQZ-së që rrëzon rekomandimin e ZRCFKSP-së, dhe të urdhërojë KQZ-në të verifikojë listën e kandidatëve dhe kandidatët e subjektit politik Demokracia Serbe në përputhje me ligjin dhe rekomandimin e ZRCFKSP.

Si dëshmi ka bashkangjitur provat: Vendimi i KQZ-së Nr. 01/2216-2025 i datës 21.8.2025. Rekomandimi i ZRCFKSP, Statuti i subjektit politik Demokracia Serbe

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se në përputhje me Planin Operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 12 Tetor 2025, periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për ka filluar më 26 qershor 2025 dhe përfundoi më 13 gusht 2025. Subjekti politik që ka aplikuar Srpska Demokratija ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim përmes platformës elektronike

më 13 gusht 2025. Ky subjekt politik ka paraqitur kandidaturat siç përcaktohet me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe të Kandidatëve të tyre, subjekti politik ka përmbushur të gjitha obligimet përmes dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm: Deklarata politike; kodi i mirësjelljes; lista e kandidatit të subjektit politik; librezë me nënshkrimet e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë (186) mbështetësve; formulari i certifikimit të kandidatit; Fletëpagesën për taksën e certifikimit. Zyra në përputhje obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin e ngarkuar nga Srpska Demokratija në platformën e certifikimit. Pas kontrollit të dokumentacionit Zyra ka anitur në përfundim se aplikimi për certifikim është i kompletuar dhe ka proceduar tutje me verifikimin e kandidatëve në lidhje me përshatshmërinë e tyre sipas kërkesave të nenit 30 të LZP. Nga të gjitha kërkesa e dërguara nga Zyra për verifikim të kandidatëve të subjektit politik Srpska Demokratija, të gjitha janë kthyer pa të gjetura për kandidatët e prezantuar nga subjekti në jalë, që nënkupton se të gjithë kandidatët e Srpska Demokratija plotësojnë e përshatshmërisë që rrjedhin nga neni 30 i LZP. Partia politike Srpska Demokratija ka përfunduar aplikimin për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të 12 Tetorit 2025 përmes platformës elektronike të KQZ me datën 13.08.2025. Zyra ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të dokumentacionit të për aplikim dhe ka dërguar listën e kandidatëve të partisë politike Srpska Demokratija për verifikimet e nevojshme të institucionet relevante në lidhje me përshatshmërinë e kandidatëve sipas kërkesave që dalin nga neni 30 i LZP. Verifikimet e listës së kandidatëve nuk kanë rezultuar me ndonjë gjetje që do të pamundësonte certifikimin e ndonjërit nga kandidatët e prezantuar në listën e partisë politike Srpska Demokratija. Partia politike Srpska Demokratija në përputhje me paragrafin 3 të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) është automatikisht e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje. Pas përfundimit të të gjitha hapave të nevojshëm për verifikim të aplikimit të partisë politike Srpska Demokratija për certifikimin e kandidatëve, Zyra për Regjistrim Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike ka rekomanduar KQZ për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Demokratija për Asamble Komunale në tetëmbëdhjetë (18) komuna dhe kandidatët për Kryetar Komune në njëmbëdhjetë (11) komuna. Nëse bie ndesh me nenin 30 të LZP, Zyra i rekomandon KQZ për mos certifikim. Ndërsa në rastin kur kanë të dhëna për kandidatët, veprimet e të cilëve janë në kundërshtim me akte ligjore ose nenligjore, por ndaj të cilëve nuk janë marrë masa apo vendime gjyqësore të formës së prerë, Zyra i rekomandon për certifikim. Ky rekomandim vë në rezultat i verifikimeve nga institucionet gjyqësore, apo verifikimeve tjera, siç përcaktohet me nenin 30 të LZP. Si rezultat i përfundimit të të gjitha verifikimeve të nevojshme për kandidatët e prezantuar në listën e subjektit politik Srpska Demokratija Zyra ka përgatitur rekomandimin për certifikimin e të gjithë kandidatëve. Në takimin nr. 50 të KQZ të mbajtur më 21.08.2025, Zyra ka prezantuar rekomandimin për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Demokratija për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të 12 Tetorit 2025. Në takimin nr. 50 të KQZ të mbajtur më 21.08.2025, Zyra ka prezantuar rekomandimin për certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Srpska Demokratija për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të 12 Tetorit 2025. Pas prezantimit të rekomandimit është hapur diskutimi në mes të anëtarëve të KQZ-së, ku gjatë diskutimit u theksua se kryetari i kësaj partie, Aleksandar Arsenijeviq dhe njëkohësisht kandidat për zgjedhje, është në kërkim nga organet e rendit për dënim për kryerjen e veprave penale. Nisur nga kjo informatë, gjithashtu është ngritur dyshimi për autencitetin e nënshkrimit të kryetarit të këtij subjekti politik Aleksandar Arsenijeviq në formularët e aplikimit për certifikim. Pas diskutimeve, rekomandimi i prezantuar nga Zyra, për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Demokratija, mori dy (2) vota për, dy (2) vota kundër dhe shtatë (7)

abstenime. Rekomandimi në fjalë nuk mori 2/3 e votave të nevojshme për tu certifikuar siç kërkohet me paragrafin 4 të nenit 63 të LZP. Rrjedhimisht, aplikimi për certifikim të listës së kandidatëve është refuzuar siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP. Rrjedhimisht, certifikimi është refuzuar siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP dhe është marrë Vendimi 01/2216-2025. Pala është njoftuar menjëherë për marrjen e Vendimit dhe është udhëzuar për të drejtën e ankesës, në përputhje me LZP. Përgjigjes se KQZ-së i ajnë bashkangjitur dokumentet si ne vijim: Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 01/2216-2025 për refuzimin e certifikimit të kandidatëve të Srpska Demokratija. Rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve, Politike për certifikimin e kandidatëve të Srpska Demokratija, Materialet e pranuar nga MPB në lidhje me profilin e Aleksandar Arsenijevic.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të lëndës rezulton se subjekti politik Demokracia Serbe, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, ka përfunduar aplikimin për certifikim si subjekt politik përfshirë edhe listën e kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Ndërsa Zyra për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, me datë 21.08.2025 ka nxjerr rekomandim, me të cilin është rekomanduar se subjekti politik Demokracia Serbe, së bashku me kandidatët e këtij subjekti politik i ka plotësuar kushtet ligjore për tu certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.08.2025, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Demokracia Serbe, përkatësisht është konstatuar se rekomandimi për certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Demokracia Serbe, nuk ka kaluar pasi që pas votimit 2 vota kanë qenë për, 2 vota kanë qenë kundër dhe 7 abstenime, dhe si rezultat rekomandimi nuk ka marrë votat e nevojshme për të kaluar duke pasur parasysh që sipas paragrafit 4 të nenit 63 të LZP, për tu certifikuar një Subjekt politik, duhet të marrë 2/3 e votave.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 21.08.2025 me numër protokolli 01/2216/2025, nuk mund të pranoi si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen certifikimit të subjektit politik dhe listës së kandidatëve, me konkretisht neneve 16, 26, 27 të LZP-së, të cilat përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e certifikimit të subjekteve politike dhe listës së kandidatëve të subjekteve politike që marrin pjesë në zgjedhje.

Paneli rikujton se, në këtë rast KQZ ka konstatuar se partia politike Demokracia Serbe automatikisht është e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, ashtu siç është përcaktuar me nenin 16 par.3 të LZP. Pra nga kjo rezulton se ky subjekt politik është i certifikuar, por që çështja

ndërlidhet me plotësimin apo jo të kushteve ligjore për certifikim të kandidatëve për kryetar të komunave dhe asambleve komunale të këtij subjekti politikë.

Me dispozitën nenit 26 paragrafi 1 të LZP-së, parashihet që: “Një subjekt politik, koalicion i subjekteve politike, ose nismë qytetare që ka aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje i dorëzon Zyrës me kohë dhe në mënyrën e përcaktuar sipas rregullave të KQZ-së listën e kandidatëve”. Ndërsa me nenin 27 par. 2 i LZP-së parasheh që: “Zyra i shqyrton të gjitha listat e kandidatëve dhe në rast të përfundimit se subjekti politik i është përgjigjur kërkesave të Kapitullit III dhe IV të këtij ligji, atëherë i rekomandon KQZ-së certifikimin e listës brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të listës”. Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 të KQZ-së për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, përkatësisht në nenin 2 pika 2 shprehimisht parashihet që: “Pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjambat e shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjambat e shqiptuara nga KQZ apo është sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe funksionimi partive politike”.

Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”

Në rastin konkret Paneli vlerëson se subjekti politik Demokracia Serbe ka aplikuar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 12 Tetorit 2025, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore nga nenet 16, 17 dhe 27 të LZP-së, ndërsa Zyra për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ ka rekomanduar certifikimin e subjektit politik, Demokracia Serbe (shtojca1), se bashku me listën e kandidatëve të tyre për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës. PZAP konsideron se vlerësimi se një kandidatë është apo jo i përshtatshëm për të qenë pjesë e listës duhet të mbështetet në kriteret ligjore që janë përcaktuar me nenin 30 LZP, ndërsa në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se rekomandimi për certifikim i listës së kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave të subjektit politik Demokracionia Serbe, është bërë pasi që paraprakisht është bërë verifikimi i të gjithë kandidatëve me të dhënat e siguruara nga institucionet përkatëse në lidhje me përshtatshmërinë e kandidatëve sipas kërkesave ligjore, përkatësisht kushteve të përcaktuara në nenin 30 të LZP.

PZAP vlerëson se vendimi i atakuar nuk përmban asnjë arsye për refuzim të certifikimit të subjektit politik, në pikëpamje të kushteve ligjore të cilat duhet t'i plotësoj një subjekt politik përfshirë listën e kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave për tu regjistruar edhe pse mekanizmi i brendshëm i KQZ-së ka rekomanduar se subjekti që ka aplikuar për tu regjistruar i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Pra vendosja në këtë rast duhet të varët nga vullneti i anëtarëve apo është obligim që vendosja t'i referohet raportit dhe kriterëve të përcaktuara ligjore për certifikim të subjekteve politike, përkatësisht të ketë vlerësim në pikëpamje të kushteve dhe kriterëve ligjore që nga mekanizmi i brendshëm i KQZ është vlerësuar se në këtë rast janë plotësuar për certifikim të subjektit politik Demokracia Serbe dhe Listës së kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave të këtij subjekti politik.

Paneli vlerëson se në vendimin e ankimuar të KQZ-së nuk janë dhënë asnjë arsye se përse është refuzuar rekomandimi i Zyrës për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ për çertifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Demokracia Serbe. Arsyetimi i vendimit të atakuar është i mangët, jo i plotë dhe nuk i ka elaboruar të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje administrative, sa i përket refuzimit të kërkesës për çertifikimin e Listës së kandidatëve për Asamble Komunale dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave të subjektit politik Demokracia Serbe. Vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marrë me respektimin e dispozitave ligjore të LZP-së dhe Rregullores 04/2024 për Çertifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Andaj Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, 131 paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet “Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala”.*

Paneli ka vlerësuar edhe përgjigjen në ankesë të KQZ-së të datës 29.08.2025, mirëpo që e njëjta nuk kishte ndonjë relevancë për të vendosur ndryshe nga ajo siç është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, kjo pasi që nuk përmban prova relevante në kuptim të kushteve ligjore lidhur me çertifikimin e atyre kandidatëve.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në, që të zbatoj vendimin e PZAP-it konform dispozitës së nenit 118 par. 5 të LZP-së.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 lidhur me nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.6/2025, datë: 29.08.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.